



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2020:184465  
Datë: 30.08.2023  
Numri i dokumentit: 04629014

**Ac.nr.786/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve Sh.R, F. K dhe A. B, të gjitha nga P..., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson F.M - avokat në P..., kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë, rr. "Agim Ramadani", pa.nr., të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës-shujtës ditore, vlera e objektit të kontestit 3,334 €, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1705/20, të datës 09.12.2021, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë **29.08.2023**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1705/20, i datës 09.12.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1705/20, të datës 09.12.2021, ka vendosur decidivisht si në vijim: "**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve Sh.R, F. K dhe A. B, të gjitha nga P..., ashtu që **DETYROHET** e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr. "Agim Ramadani", pa.nr., që në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës (shujtave) paditëseve tua paguaj shumat dhe atë: -Paditëses Sh.R, për 575 ditë pune shumën prej 1,150.00 euro; -Paditëses F.K, për 590 ditë pune shumën prej 1,180.00 euro; -Paditëses A.B, për 502 ditë pune shumën prej 1,004.00 euro. **II. DETYROHET** e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr. "Agim Ramadani", pa.nr., që paditëseve shumen e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguaj me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë me datë 24.12.2020, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 498.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm"

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës dhe ta prish aktgjykimin e atakuar.

Paditëset nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 24.12.2020 kanë parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës duke kërkuar që të obligohet e paditura në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës, me arsyet sikurse në padi, e po ashtu duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr. 1705/20, të datës 09.12.2021, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditëset kanë qenë të punësuara te e paditura, në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (Q.B.M.K.) “Xh. D”, në P..., pasi që kjo vërtetohet edhe nga kontratat e punës me nr. protokollit 3/1048-27 e dt. 02.03.2016 për Sh.R, kontrata e punës me numër protokollit 3/1048-8 e dt. 02.03.2016 për F.K, kontrata e punës për me numër protokollit 3/7-2094 e dt. 30.05.2017 për A. B, të lidhura në mes të paditëseve dhe të paditurës. Tutje ka theksuar se nga vërtetimet e lëshuara nga Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim (Q.B.M.K.) “Xh. D”, në P..., vërtetohet fakti se paditësja Sh. R nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020 ka gjithsej 575 ditë pune, paditësja F. K nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020 ka gjithsej 590 ditë pune dhe paditësja A. B nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020 ka gjithsej 502 ditë pune. Nga kërkesat e paditëseve për pagesën e shujtës të dt. 13.11.2020, vërtetohet fakti se paditëset i janë drejtuar të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa, nga përgjigja në kërkesë me numër protokollit 3180-3213 e dt. 19.11.2020, e paditura ua ka refuzuar kërkesën paditëseve me arsyetimin se MASH dhe MF nuk kanë planifikuar buxhet shtesë për këtë çështje. Lidhur me bazën ligjore është mbështetur në nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit para Universitar të lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Vendimin mbi kamatën e ka marrë duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, vendimin për shpenzimet që pala e paditur ti bartë ato e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449, 452, 453.1 dhe 463 të LPK-së dhe Tarifës së OAK-së.*(më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimin të atakuar).*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2,

pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e po ashtu e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas Gjykatës së Apelit provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës janë prova të pakontestueshme dhe të njëjtat kanë arsyetuar bindshëm mënyrën e vendosjes sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se: me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9“*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëseve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës, 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), të cilat kontrata kanë qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve ushqimit për ditët në punë (kontrata e vitit 2017, i ka njohur të drejtën për shujtë paditëseve për periudhën sa ka qenë në fuqi), që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko – civil i të paditurës ndaj paditëseve në emër të pagesës për kompensimin e ushqimit (shujtës) gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien*

*e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditëseve t’iu paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës ( MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit e shqyrtoi edhe pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me vlerën e kontestit dhe sqaron se në shkresat e lëndës gjendet aktvendimi korigjues i gjykatës së shkallës së parë C.nr. 1705/20, i datës 07.02.2022, me të cilin shumë prej 13,433 € e ka korigjues me shumë që duhet të jetë 3,334 € dhe se ky korigjim është pjesë përbërëse e aktgjykimit burimor C.nr. 1705/20 të datës 09.12.2021. Kjo gjykatë vlerëson bazuar në nenin 165 par. 1 të LPK-së, ku është paraparë korigjimi aktgjykimit është shprehimisht është përcaktuar se *“Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korigjon gjykata në çdo kohë”*. Andaj, bazuar në këtë dispozitë, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform kësaj dispozite ligjore dhe refuzon të gjitha pretendimet ankimore të të paditurës të paraqitura në këtë drejtim.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsytuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË**  
**Ac.nr.786/2022, datë 29.08.2023**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Lumni Sallauka**